# ALBANIAN DISTRIBUTION & DEVELOPMENT Shpk
# NIPT-I K21308001C

Selia: Ruga Thaskal Tod'hri, Godina Nr. 35, Kashar
Tiranë – Shqipëri

## Pasqyrat Financiare për periudhën e mbyllur me 31 Dhjetor 2017
( me raportin e audituesit të pavarur ne vazhdim)

Tirane, 29 Mars 2018

**Përmbajtja**

1. Opinioni i Audituesit të Pavarur
2. Bilanci Kontabël
3. Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve
4. Pasqyra e flukseve monetare
5. Pasqyra e ndryshmeve në kapital

Albanian Distrubution & Development" shpk

Tirane

# Raport

## Per auditimin e Pasqyrave Financiare te mbyllura me 31 Dhjetor 2017

Auditues Ligjor

Dashnor MEMISHI

RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR

**Ortakëve të Shoqërisë**

**"ALBANIAN DISTRUBUTION & DEVELOPMENT"Sh.p.k**

**Tiranë-Shqiperi**

**Opinioni**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë tregtare **Ortakëve të Shoqërisë "ALBANIAN DISTRUBUTION & DEVELOPMENT"Sh.p.k** , të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2017, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë me datën 31 Dhjetor 2017, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Nderkombëtare të Raportimit Financiar (SRNF-te

**Baza për opinionin**

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

**Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK-të, dhe për ato kontrolle të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërise

**Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.
Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, indiviualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.

- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.

- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në

përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi marrë ofrojnë baza të arsyeshme për dhënien e opinionit të auditimit.

Tiranë më 30.03.2018

AUDITUES LIGJOR

**Dashnor MEMISHI**

*Rr. e Durrësit, Kulla e "Fratarit", Shk. 2, Ap. 10 c,*
*Tiranë Tel: 068 20 43 301*

# ALBANIAN DISTRIBUTION & DEVELOPMENT Shpk

PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME 31 DHJETOR 2017 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

*SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHE SHKRUHET*

| Pasqyra e Situates Financiare | Shënime | 31.12.2017 | 31.12.2016 |
|---|---|---|---|
| **AKTIVET** | | | |
| **Aktivet Afatshkurtëra** | | | |
| **Aktive monetare** | 5 | **811,846,088** | **619,074,349** |
| **Aktive të tjera financiare afatshkurtra** | 6 | | |
| *Llogari/Kërkesa të arkëtueshme* | 6.1 | 388,016,060 | 398,148,477 |
| *Llogari/Kërkesa të tjera të arkëtueshme* | 6.2 | 123,584,623 | 43,691,340 |
| *Te drejta ndaj organeve tatimore, doganore* | 6.3 | 5,369,059 | 3,806,789 |
| **Totali** | | **516,969,742** | **445,646,605** |
| **Inventari** | 7 | | |
| *Mat. te para dhe ndihmese* | | 27,287,157 | 25,300,200 |
| *Ambalazh I kthyeshem* | | 3,195,752 | 9,864,074 |
| *Mallra per rishitje* | | 301,025,316 | 249,422,933 |
| **Totali** | | **331,508,225** | **284,587,206** |
| **Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra** | 8 | 18,990,922 | 9,692,448 |
| **Total i Aktiveve Afatshkurtra** | | **1,679,314,978** | **1,359,000,609** |
| **Aktivet Afatgjata** | | | |
| **Aktive të tjera financiare afatgjata** | 9 | | |
| *Hua dhe te tjera* | 9.1 | 371,698,685 | 330,742,589 |
| **Investimet finaciare afatgjata** | 10 | | |
| Aksione dhe investime te tjera ne pjesmarrje | 10.1 | 66,203,963 | 66,785,178 |
| **Aktive afatgjata materiale** | 10.2 | | |
| *Makineri dhe pajisje pune* | 10.2 | 46,464,418 | 30,378,190 |
| *Aktive të tjera afatgjata materiale (me vl.kontab. neto)* | 10.2 | 235,709,717 | 233,309,429 |
| **Totali AAM** | | **282,174,135** | **263,687,618** |
| **Totali I Aktiveve Afatgjata** | | **720,076,782** | **661,215,385** |
| **TOTALI I AKTIVEVE** | | **2,399,391,760** | **2,020,215,994** |
| **DETYRIMET Afatshkurtëra** | 11 | | |
| **Huat dhe parapagimet** | 11.1 | | |
| *Të pagueshme ndaj furnitorëve* | 11.2 | 342,667,841 | 298,235,661 |
| *Detyrime tatimore* | 11.3 | 30,867,351 | 51,867,079 |
| *Detyrime te tjera, ortake dhe te tjere* | 11.4 | 18,278,125 | 92,138,092 |
| *Hua të tjera* | 11.5 | 74,161,234 | 71,216,772 |
| **Totali** | | **465,974,551** | **513,457,604** |
| **Grantet dhe te ardhurat e shtyra** | 11.6 | **4,373,348** | **4,198,369** |
| **Totali i detyr. afatshkurtra** | | **470,347,899** | **517,655,973** |
| **DETYRIME AFATGJATA** | | | |
| **Huat afatgjata** | | | |
| Hua pjesa afatgjate | 11.7 | 108,388,189 | 179,846,624 |
| Hua dhe detyrime nga qiraja financiare | 11.8 | 14,284,023 | 23,205,373 |
| Grantet dhe te ardhurat e shtyra | 11.9 | 17,493,393 | 16,793,178 |
| **Totali i detyrimeve afatgjata** | | **140,165,605** | **219,845,175** |
| **TOTALI I DETYRIMEVE** | | **610,513,504** | **737,501,148** |
| **Kapitali** | 12 | | |
| *Kapitali aksionar* | | 700,000,000 | 700,000,000 |
| *Rezervat statutore* | | 537,769 | 537,769 |
| *Rezervat ligjore* | | 69,462,230 | 69,462,230 |
| *Rezervat te tjera* | | 1,084,861,365 | 676,508,867 |
| *Rezerva nga rivleresimi* | | -572,146,518 | -572,146,518 |
| *Fitimi (humbja) e vitit financiar* | | 506,163,412 | 408,352,498 |
| **Totali i kapitalit** | | **1,788,878,259** | **1,282,714,847** |
| **TOTALI I DETYRIMEVE KAPITALIT** | | **2,399,391,760** | **2,020,215,994** |

*Pasqyrat Financiare janë të lexueshme së bashku me shënimet shpjeguese 1-16*

Republika e Shqipërisë • ALBANIAN DISTRIBUTION & DEVELOPMENT • Export - Import • Adresa: Autostrada Tiranë - Durrës Km.9

*SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHE SHKRUHET*

**Pasqyra e Të Ardhurave Totale Gjitheperfshirese**
**Për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2017**

| **Veprimtaria e zakonshme** | **Shënimi** | **Viti 2017** | **Viti 2016** |
|---|---|---|---|
| **Pershkrimi I Elementeve** | | | |
| Shitjet neto | 13.1 | 4,651,710,846 | 4,135,585,246 |
| Te ardhura te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit | 13.2 | 57,949,068 | 46,652,928 |
| Mallra dhe materialet e konsumuara | 13.3 | 3,449,847,528 | 3,060,545,978 |
| Kosto e punes | 13.4 | 166,638,094 | 154,433,352 |
| *-pagat e personelit* | | 145,945,095 | 135,389,369 |
| *-shendetesore* | | 20,692,999 | 19,043,983 |
| Amortizime dhe zhvleresime | 13.5 | 60,037,655 | 62,920,807 |
| Shpenzime te tjera | 13.6 | 426,233,122 | 406,353,634 |
| **Totali I shpenzimeve** | | **4,102,756,399** | **3,684,253,772** |
| **Fitimi apo (humbja) nga veprimtaria kryesore** | | **606,903,516** | **497,984,402** |
| Te ardhurat dhe shpenzimet financiare | | | |
| Te ardhura dhe shpenzime nga interesat | 13.7 | 2,164,915 | 8,073,838 |
| Fitimet (humbjet) nga kursi I kembimit | 13.8 | 4,398,982 | 4,371,113 |
| Fitimet (humbjet) nga shitja e aksioneve | | | |
| **Totali I te ardhurave dhe shpenzimeve financiare** | | **6,563,897** | **12,444,952** |
| **Fitimi (humbja) para tatimit** | | **600,339,618** | **485,539,450** |
| Shpenzimet e tatimit mbi fitimin | | 94,176,206 | 77,186,952 |
| **Fitimi (humbja) neto e vitit finaciar nga veprimtaria e zakonshme** | **14** | **506,163,412** | **408,352,498** |
| | | | |
| **Te Ardhura te tjera gjithperfshirese** | | | |
| Fitime (Humbje nga rivleresimi I AAM) | | - | - |
| **Te Ardhura te tjera gjithperfshirese** | | - | - |
| | | | |
| **Totali I te ardhurave gjitheperfshirese per periudhen** | | 506,163,412 | 408,352,498 |

*Pasqyrat Financiare janë të lexueshme së bashku me shënimet shpjeguese 1-16*

Pasqyrat Financiare **Albanian Distribution & Developement** janë aprovuar nga Drejtimi i Degës
Më datë 29 Mars 2018

Administrator
Xhafer Xhako

Hartues i Pasqyrave Financiare
Blerta Zenelaj

Republika e Shqipërisë
ALBANIAN DISTRIBUTION & DEVELOPMENT
Export - Import
Adresa: Autostrada Tiranë - Durrës Km.9

## Pasqyra e flukseve monetare

Për periudhën që mbyllet më 31 Dhjetor 2017

| | Viti 2017 | Viti 2016 |
|---|---|---|
| **Fluksi monetar nga veprimtarite e shfrytezimit** | **271,295,889** | **416,479,104** |
| Fitimi para tatimit | 600,339,618 | 485,539,450 |
| Rregullime per: | 60,037,655 | 62,920,807 |
| *Amortizimin* | *60,037,655* | *62,920,807* |
| Rritje/renie ne tepricen e kerkesave te arketueshme nga aktiviteti, si dhe kerkesave te arketueshme te tjera | -120,996,515 | *-19,898,292* |
| Rritje/renie ne tepricen e inventarit | -46,921,019 | *13,749,468* |
| Rritje/renie ne tepricen e detyrimeve, per tu paguar nga aktiviteti | -126,987,644 | *-48,645,378* |
| **MM te perfituara nga aktivitetet** | *365,472,095* | ***493,666,056*** |
| Tatim mbi fitimin I paguar | -94,176,206 | -77,186,952 |
| ***MM neto nga aktivitetetet e shfrytezimit*** | ***271,295,889*** | ***416,479,104*** |
| **Fluksi monetar nga veprimtarite investuese** | | |
| Blerje aksionesh dhe letra te tjera me vlere | | -48460287.66 |
| Blerjet e aktiveve afatgjata materiale | -96,637,256 | -46,834,388 |
| Shitja e aktiveve afatgjata materiale | 18,113,105 | 13,179,988 |
| ***MM neto te perdorura ne veprimtarite investuese*** | ***-78,524,151*** | ***-82,114,688*** |
| **Fluksi monetar nga aktivitetet financiare** | | |
| Te ardhurat nga ememtimi i kapitalit aksionar | | |
| Dividende te paguar | | |
| ***MM neto e perdorur ne veprimtarite financiare*** | ***0*** | ***0*** |
| **Rritja/renia neto e mjeteve monetare** | **192,771,738** | **334,364,417** |
| **Mjetet monetare ne fillim te periudhes kontabel** | **619,074,350** | **284,709,933** |
| **Mjetet monetare ne fund te periudhes kontabel** | **811,846,088** | **619,074,350** |

*Pasqyrat Financiare janë të lexueshme së bashku me shënimet shpjeguese 1-16*

Republika e Shqipërisë • ALBANIAN DISTRIBUTION & DEVELOPMENT • Export - Import • Adresa: Autostrada Tiranë - Durrës Km.9

*SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHE SHKRUHET*

**Pasqyra e ndryshimeve ne kapitalet e veta**

| | Kapitali aksionar | Rezerva statutore | Rezerva ligjore | Rezerva te tjera | Rezervang a rivleresimi | Fitimi USHTRIMIT | TOTALI |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Pozicioni me 31 dhjetor 2015** | **700,000,000** | **537,769** | **69,462,230** | **302,371,995** | **476,820,452** | **374,136,963** | **969,688,505** |
| Fitimi neto per periudhen kontabel | | | | | | 408,352,498 | **408,352,498** |
| Rritja rezerves kapitalit | | | | 374,136,963 | | - 374,136,963 | - |
| Kapiatlizimi I fitimit | - | | | | | - | - |
| Kapitalizimii rezervave | - | | | | | | - |
| Reserve nga rivleresimi | | | | | 95,326,066 | | **95,326,066** |
| Rritja e rezervave ligjore | | | | | | | - |
| Emetimi kapitali aksionar | | | | | | | - |
| Aksione te thesari te riblera | - | | | | | | - |
| **Pozicioni me 31 dhjetor 2016** | **700,000,000** | **537,769** | **69,462,230** | **676,508,867** | **572,146,518** | **408,352,498** | **1,282,714,847** |
| Fitimi neto per periudhen kontabel | | | | | | 506,163,412 | **506,163,412** |
| Dividentet e paguar | | | | | | | - |
| Rritja rezerves kapitalit | | | | 408,352,498 | | -408,352,498 | - |
| Kapiatlizimi I fitimit | - | | | | | | - |
| Kapitalizimii rezervave | - | | | | | | - |
| Reserve nga rivleresimi | | | | | | | - |
| Rritja e rezervave ligjore | | | | | | | - |
| Emetimi kapitali aksionar | - | | | | | | - |
| **Pozicioni me 31 dhjetor 2017** | **700,000,000** | **537,769** | **69,462,230** | **1,084,861,365** | **572,146,518** | **506,163,413** | **1,788,878,259** |

*Pasqyrat Financiare janë të lexueshme së bashku me shënimet shpjeguese 1-16*